| Nr. Regj. | Data e paraqitjes së kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 27.01.2022 | Kërkesë për informacion: Kërkesë për datë gjyqi | 31.01.2022 | Çështja me palë kërkuese Brunilda Mani dhe person të tretë – Njësia Administrative Koplik, Zyra e Gjëndjes Civile Koplik, pas kthimit për rigjykim me datë 20.12.2021, nga Gjykata e Apelit Shkodër , cështja është rregjistruar në sistemin e Menaxhimit të të dhënave gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dhe pas shortimit të parë pas kësaj date , konkretisht me datë 10.01.2022 ka kaluar pranë gjyqtares Ermira Dedja .<br>Gjyqtarja Ermira Dedja është shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit pas rivlerësimit të statusit të saj me datë 12.01.2022.<br>Në të tilla kushte me rishortimin e çështjeve të kësaj gjyqtare do caktohet edhe gjyqtari i ri për gjykimin e çështjes suaj.<br><br>Për informacione të mëtejshme ju mund të kontaktoni me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër , në adresat elektronike :<br><br>• Info.Gjykata.Shkoder@gjykata.gov.al<br>• Njoftime.Gjykata.Shkoder@gjykata.gov.al<br>I. | E plotë | Me postë elektronike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 02.02.2022 | Plotësim ankete | 08.02.2022 | Plotësuar anketa, bashkëlidhur materiali | E plotë | Me postë elektronike |
| 3 | 15.03.2022 | Kërkesë për informacion në lidhje me vendimet gjyqësore për zgjedhjet e 6 Marsit | 15.03.2022 | Në lidhje kërkesën informojmë se nga verifikimi në sistemin ICMIS, që menaxhon të dhënat gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në rregjistrat rezulton se pranë kësaj gjykate për periudhën 05.03.2022- 06.03.2022, për zgjedhjet e pjesshme të pushtetit vendore të datës 06.03.2022, janë paraqitur 6 kërkesa, si më poshtë:<br>• 2 (dy) kërkesa me objekt "Ndryshim i listës pas shpalljes së listes përfundimtare në zgjedhjet e pjesshme për pushtetin vendor"ku për njërën është vendosur "kthimi i akteve " dhe për tjetrën është vendosur pranimi (kërkesa këta të paraqitura me datë 05.03.2022;<br>• 4 (katër) kërkesa me objekt: "Kërkesë për lejim votimi pasi emri nuk është në listë" për të cilat është vendosur "Kthimi i akteve" (kërkesa këta të paraqitura më datë 06.03.2022). | Përgjigje e plotë | Me postë elektronike dhe shkresë zyrtare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 17.03.2022 | Vendosjen në dispozicion të kërkesave për gjykim për shtetasit B.T dhe M.L(S) | 29.03.2022 | Çështja ka filluar në gjykim paraprak me dyer të mbyllura (siç përcakton Kodi i Procedurës Penale për këtë kategori gjykimi, neni 332/b "*Seanca zhvillohet me dyer të mbyllura, me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit*), dhe me datë 29.12.2021 pas pranimit të këerkesës së palëve për gjykim të shkurtuar ka kaluar në gjykim themeli, duke përfunduar këtë gjykim në shkallë të parë me datë 16.03.2022, konkretisht gjykata ka disponuar mbi këtë kërkesë të prokurorisë me vendimin nr. 322 datë 16.03.2022 i cili nga verifikmet e realizuara në kryesekretari nuk ka marrë formë të prerë , pasi është në fazë komunikimi të vendimit referuar nenit 386 pika 2 dhe 415 të Kodit të Procedurës Penale , duke u konsideruar kështu gjykim në proces (pra jo i përfunduar).<br><br>Sa më sipër referuar: Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 17 i tij, pika 2 gërma "dh" përcakton se: E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse *dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë* ndaj interesave të mëposhtëm :<br>• Pika "dh" - ***barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor*** dhe ky kufizim bie (gjithmonë referuar nenit 17 pika 2 ) në rastin kur të dhënat të dhënat janë fakte, analiza të fakteve, të dhëna teknike ose të dhëna statistikore .<br>• Të dhënat objekt e kërkuara nga ana juaj nuk janë fakte, analiza të fakteve, | Përgjigje e kufizuar sa i përket vendosjes në dispozicion të materialit (dokumentacionit), dhënë informacion | Me postë elektronike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të dhëna teknike ose të dhëna statistikore. Ato janë të dhëna mbi një gjykim që po zhvillohet, që I përkasin përfundimeve të një hetimi referuar një akuze që prokuroria ka ngritur dhe paraqitur në gjykatë (prova akte ekspertimi, deklarime etj), për të cilën gjykata nuk është shprehur me vendim të formës së prerë. Referuar si më poshtë Kushtetutës, të dhënat e këtij gjykimi, cënojnë interesin dhe shkaktojnë dëm në gjykimin e shtetasit, përderisa nuk ka vendim fajësie të formës së prerë për të.<br><br>1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 30 të saj përcakton "Kushdo quhet i pafajshëm *përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë*", (duke vijuar argumetin e mësipërm).<br><br>Në të tilla kushte referuar sa më sipër informacioni objekt i kërkesës suaj kufizohet plotësisht për shkak të ligjit "Për të drejtën e Informimit", pasi çështja është në proces gjyqësor deri në marrjen formë të prerë të vendimit ,*përveç informacionit mbi gjendjen e gjykimit të kësaj çështje ,që u pasqyrua në pragrafin e parë të kësaj shkrese.*<br><br>Informacion më të detajuar në lidhje me përfundimin e këtij gjykimi ju mund të kërkoni pas përfundimit të gjykimit me vendim të formës së prerë, në respektim | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor (Kreu IV). | | |
| 5 | 17.03.2022 | Kerkese për informacion:<br>• Gjatë periudhës Maj 2020 – Mars 2022, në zbatim të neneve 89/b dhe 242/a të Kodit Penal, a janë dhënë vendime gjyqësore ndaj shtetasve të pandehur?<br>• A dispononi statistika mbi numrin e vendimeve dhe dënueshmërinë e shtetasve të pandehur për këto vepra penale gjatë kësaj periudhe?<br>Informacioni i mësipërm u kërkua për periudhën 01.05.2020-29.03.2022 | 29.03.2022 | 1. Nga verifikimi në numratorët penal prej datës 01.05.2020 – 29.03.2022 rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka dhënë asnjë vendim penal me bazë ligjore nenin 89/B të Kodit Penal nën titullin “Përhapja e sëmundjeve infective”, dhe as me nenin 242/a të Kodit Penal nën titullin “Moszbatimi i masave të autoriteteve shtetërore gjatë gjendjes së masave të jashtëzakonshme apo gjatë gjendjes së epidemisë”.<br><br>2. Në lidhje me pikën e dytë të kërkesës suaj ju informojmë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër përpunon të dhëna statistikore mbi tabelat e miraturara me Udhëzim të Ministrit të Drejtësisë dhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndër të cilat nuk janë përfshirë nenet 89/b dhe 242/a të Kodit Penal. | E plotë | Me shkresë zyrtare |
| 6 | 17.03.2022 | Kërkesë për informacion mbi zgjedhjet 06.Mars: | 29.03.2022 | 1. Në lidhje me pikën 1, të kërkesës suaj, siç i është kthyer përgjigje më shkresën nr. 400/1 prot datë 15.03.2022 gazetares së KRIIK znj. Antonjeta Pero rezulton se pranë kësaj gjykate për periudhën 05.03.2022-06.03.2022, për zgjedhjet e pjesshme të | Përgjigje plotë | Me shkresë zyrtare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pushtetit vendore të datës 06.03.2022, janë paraqitur 6 kërkesa,  si më poshtë:<br>• 2 (dy) kërkesa me objekt “Ndryshim i listës pas shpalljes së listes përfundimtare në zgjedhjet e pjesshme për pushtetin vendor”ku për njërën është vendosur “kthimi i akteve “ dhe për tjetrën është vendosur pranimi (kërkesa këta të paraqitura me datë 05.03.2022;<br>• 4 (katër) kërkesa me objekt: ” Kërkesë për lejim votimi pasi emri nuk është në listë” për të cilat është vendosur “Kthimi I akteve”  (kërkesa këta të paraqitura më datë 06.03.2022).<br>2. Në lidhje me pikën e dytë ju vendosim në dispozicion kopje të vendimeve të sipër cituara në format të anonimizuar.<br>3. Në lidhje me pikën 3 informojmë se:  Shtetasi Bardh Spahia, në cilësinë e kërkuesit ka paraqitur kërkesë me objekt “Ndryshim i listës pas shpalljes së listes përfundimtare në zgjedhjet e pjesshme për pushtetin vendor”, për të cilën Gjykata ka dhënë vendimin nr. 34 (824), datë 05.03.2022.<br>4. Në lidhje pikën e katërt: Vendimi nr. 34 (824), datë 05.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjqyësor Shkodër ju është vendosur në dispozicion referuar pikës 2 të kësaj shkrese.<br><br>5. Në lidhje me pyetjen 5, informojmë se kërkesat e vetme të paraqitura me objekt | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Listatat zgjedhore të zgjedhjeve për pushtetin vendos datë 06.03.2022 janë ato të pasqyruara në pikën 1 të kësaj shkrese dhe vendimet e marra janë ato të pasqyruara në pikën 2. Po të kësaj shkrese.<br>6. Në lidhje me pikën 6: Nuk rezulton të jenë paraqituar çështje gjyqësor epër gjykim nga ana e prokurorisë apo subjekte të tjera me bazë ligjore Kreun X të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve", Nenet 325-332, në periudhën janar 2022 deri datë të kthimit të kësaj përgjigje.<br>7. Përgjigjja e kësaj pyëtje është e njëjtë me atë të pikës 6. | | |
| 7 | 31.03.2022 | Kerkese per informacion me link bashkelidhur | 08.04.2022 | Plotësuar linku dhe njoftuar kërkuesi | Pergjigje e plotë | Me postë elektronike |
| 8 | 07.04.2022 | Kërkesë për informacion për mandatin e kryetarit të Bashkisë | 13.04.2022 | Vendosjen në dispozicion të vendimit | Përgjigje e plotë | Me postë elektronike |
| 9 | 13.04.2022 | Kërkesë për informacion për një vendim | 26.04.2022 | Vendosja në dispozicion e vendimit nr. 51-2020-5462 I anonimizuar | Përgjigje e plotë | Me shkresë zyrtare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | 09.05.2022 | Kërkesë për informacion në lidhje me çështje civile dhe penale të dhëna nga kjo gjykatë për shtëtasin E.A | 19.05.2022 | Vendos në dispozicion të gjitha vendimet e anonimizuara | Përgjigje e plotë | Me postë elektronike dhe shkresë zyrtare |
| 11 | 10.05.2022 | Kërkesë për informacion në lidhje me të miturin në konflikt me ligjin | 20.05.2022 | Informacion mbi çështjen anonimizuar emri i të miturit | Përgjigje e pjesshme | Me postë elektronike |
| **12** | 13.05.2022 | Kërkesë për informacion mbi çështje me object "Shpërblim dëmi" | 24.05.2022 | Nga verifikimi në sistemin ICMIS, që menaxhon të dhënat gjyqësore për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër prej vitit 2010 e në vijim, u nxorën të dhënat për çështjet gjyqësore ku Byroja Shqiptare e Sigurimit, si për çështjet në gjykim ashtu edhe për ato të përfunduara për harkun kohor 01 Janar 2022 -24 Maj.2022<br><br>• Bashkelidhur gjeni tabelën me të dhënat e çështjeve në gjykim dhe atyre përfunduar nga Janari 2022 deri datë 24.05.2022 | Përgjigje plotë | Me shkresë zyrtare |
| 13 | 19.05.2022 | Kërkesë për informacion nëse gjykohet çështje me palë GJ.A, L.A; P.A | 24.05.2022 | Kthyer informacioni në lidhje me çështjet që po gjykohen ose jo me shtetasit GJ.A, L.A, P.A | E plotë | Me shkresë zyrtare |
| 14 | 24.05.2022 | Kërkesë për informacion ne lidhje me gjykimet me objekt "Zgjidhje martese dhe Urdhera mbrojtje për tre vitet e fundit dhe 3 muajrin e pare te 2022 | 31.05.2022 | Vendosur në dispoozicion tabelat statistikore mbi kërkimin e paraqitur | E plotë | Me postë elektronike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | 30.05.2022 | Kërkesë për informacion në lidhje me gjykimet me objekt “Zgjidhje martese” tre vitet e fundit | 01.06.2022 | Vendosur në dispozicion tabelat statistikore mbi kërkimin e paraqitur | E plotë | Me postë elektronike |
| 16 | 02.06.2022 | Kërkohen të dhëna statistikore në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimeve | 07.06.2022 | Kthyer përgjigje duke i vendosur të dhënat statsistikore në dispozicion | E plotë | Me postë elektronike |
| 17 | 02.06.2022 | Kërkesë për informacion :<br>Numri i familjeve të ngujuara/<br>Numri i njerëzve të mbyllur në shtëpi<br>Nr. i personave të dënuar për gjakmarrje<br>Opinion i autoritetit lokal | 13.06.2022 | Përgjigje negative pasi gjykata nuk ka dijeni mbi sa kërkuar dhe nuk i grumbullon këta të dhëna. Në lidhje me të dënuarit është kërkuar konkretizimi i veprës penale. Tërhequr kërkuesi nga kërkesa | Kufizuar për shkak se nuk ka informacion mbi kërkesën gjykata | Me postë elektronike |
| 18 | 03.06.2022 | Kërkesë për informacion në lidhje me sa çështje janë gjykuar për 5 vitet e fundit për dhenie parash me fajde | 17.06.2022 | Paraqitur informacioni në lidhje me kërkimin në formë statistikore për çdo vit ndërsa në lidhje me vendimet është kufizuar duke ia përcjellë të anonimizuar | E plotë | Me postë elektronike |
| 19 | 08.06.2022 | Kërkesë për informacion:<br>Kopje të të gjithë vendimeve të çështjeve për divorcet e kryera në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër për tre vitet e fundit.<br>Kopje të të gjithë vendimeve të urdhërave të mbrojtjes të kërkuara nga femrat në Gjykatën e | 21.06.2022 | Sa më sipër, siç jeni vënë në dijeni në kthimin e përgjigjes të kërkesës suaj të mëparshme për informacion mbi numrin e vendimeve per zgjidhje martese dhe numrin e urdhërave të mbrojtjes mbi tre vitet e fundit, te protokolluar me nr. 699/1 prot., bëhet fjalë për një numër të konsiderueshëm vendimesh, prej të cilëve çdonjëri përmban të dhëna personale, të cilat, në zbatim edhe të Udhëzimit Nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të | E paplotë | Me postë elektronike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Rrethit Gjyqësor Shkodër për tre vitet e fundit.<br>Kërkoj që informacioni të më dërgohet në rrugë elektronike brenda javes | | dhënave personale në sistemin gjyqësor (Kreu IV), duhen përcjellë të anonimizuar.<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se koha e nevojshme për përpunimin e materialit të kërkuar është më e gjatë se një javë (kohë brenda së cilës, kërkoni të ju vihet në dispozicion materiali). Përsa i përket këtij kërkimi, ju bëjmë me dije se përpunimi i tij është shumë voluminoz dhe përbën kosto kohore dhe materiale, ndaj jeni e lutur të specifikoni kërkimin tuaj, mbi numrin e vendimeve që kërkoni të ju vihet ne dispozicion, si dhe të kryeni parapagimin mbi shërbimin e kërkuar, në mënyrë që të reduktohet koha dhe kostoja e marrjes së informacionit.<br>Tërhequr kërkuesi nga kërkesa | | |
| 20 | 13.06.2022 | Kërkesë për informacion :<br>1.Sa persona janë proceduar nga viti (2014 deri Prill 2022 për shkelje të ligjit që lidhet me cannabis Sativa ;<br>2. Sa nga këto është kërkuar nga prokuroria caktimi I mases se sigurimi arrest në burg;<br>3. Sa nga këto janë kërku masa të tjera ;<br>4. Sa nga këto është kërkuar dërgimi I ceshtjes në gjyq | 04.07.2022 | Shtyerje afati te kthimit të pergjigjes me 5 ditë pune për shkak të volumit të dokumentacionit që duhet shqyrtuar<br>Përcjellë të dhënat me tabela statistikore | E plotë | Me postë elektronike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | 22.06.2022 | Kërkesë për informacion në lidhje me pranimin/pranimin e pjesshem/rrezimin e kërkesës së viktimave të dunës me bazë gjinore për ndihmë juridike dytësore falas dhe me pranimin/pranimin e pjesshem/rrezimin e kërkesës për përjashtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore nga pagimi I tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore | 04.07.2022 | Përcjellë vendimet përkatëse me këto objekte | E plotë | Me shkresë zyrtare |
| 22 | 28.06.2022 | Kërkesë për informacion në lidhje me çështjet me objekt Krimin kibernetik Te dhena statistikore për dy vitet e fundit | 06.07.20 22 | Përcjellë të dhënat statistikore me tabela | E plotë | Me postë elektronike |
| 23 | 13.09.2022 | Kërkesë për informacion në lidhje me përfundimin e marrëdhënieve të punës për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës nga ana e institucionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën 2017-2022 | 27.09.2022 | Kthim të përgjigjeve përkatëse sipas pyetjeve të shtruara nga ana e kërkuesit të informacionit | E plotë | Me postë elektronike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 24 | 11.11.2022 | Kërkesë për informacion:<br><br>Në kuadër të programit mësimor, nëpërmjet këtij e-mail me mirësjellje kërkoj të më dërgoni në format elektronik vendimet gjyqesore të dhëna nga gjykata juaj nga viti 2010 deri më sot, për çështje penale me objekt akuze:<br><br>- neni 78 i Kodit Penal "Vrasja me paramendim" dhe<br>- neni 79/c i Kodit Penal "Vrasja ne rrethana familjare". | 23.11.2022 | Vënie në dispozicon të linkut të faqes zyrtare elektronike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila është publike dhe e aksesueshme nga çdo subjekt i interesuar. Konkretisht mund të kërkohet me bazën ligjore në fushën e kërkimit sipas neneve përkatëse. | E plotë | Me postë elektronike |
| 25 | 24.11.2022 | Kërkesë për informacion mbi veprimtarinë e gjykatës për çështjet me objekt: UMM, UM, Dhunë në familje për 9mujorin janar-shtator 2022 | 01.12.2022 | Vënie në dispozicion të informacionit statistikor në lidhje me kërkesat e paraqitura dhe të gjykuara me objekt UMM, UM, Dhunë në familje | E plotë | Me postë elektronike dhe shkresë zyrtare |
| 26 | 25.11.2022 | Informacion për proceset gjyqësore të zhvilluara me të pandehur të mitur gjatë 9mujorit janar-shtator 2022. Në sa prej tyre janë shpallur të pafajshëm, në | 14.12.2022 | Vënie në dispozicion të informacionit për çështjet e regjistruara me të mitur për 9mujorin janar-shtator 2022, konkretisht numrat e çështjeve ku është vendosur pushimi I gjykimit, deklarimi I pafajësisë dhe çështjet ku I mituri është viktimë. | E plotë | Me postë elektronike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sa prej tyre janë viktima, dhe sa janë pushuar? | | | | |